



|                                        |            |
|----------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO |            |
| KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN    |            |
| 01 Nr. / Br.                           | 40/25      |
| Nr. i fq. / Br. sh.                    | - 2 -      |
| Data / Datum                           | 28.02.2025 |
| VUSHTRRI - VUČITRN                     |            |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

### PROCESVERBAL

**nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 29 janar 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:45.**

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Zdravko Zdravković (kryesues), Kushtrim Hyseni, Zojë Hajrizi, Behar Duraku, Gresa Muli, Zana Krasniç Saraçi, Berat Maloku, Aziz Emini dhe Adem Hoti, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësues të KFOR-it slloven, OSBE-së, UNMIKUT, Aktere Dërvvari - përkthyes, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Zdravko Zdravković, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë.

***Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:***

### RENDITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2024;
3. Diskutime lidhur me hartimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025;
4. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

***Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.***

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

**Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit** – besoj se të gjithë e keni pranuar raportin vjetor, ku i kam përmbledhur të gjitha pikat në një vend. Në këtë raport i kam futur shqyrtimet, diskutimet, rekomandimet e komitetit. Këtë raport do t'ia dërgojmë Kuvendit të Komunës.

**Aziz Emini, anëtar i komitetit** - tha se do të ndërlidhem me raportin vjetor, ku do të flas për sukseset dhe mosukseset gjatë vitit 2024. Kam paraqitur në komitet disa çështje gjatë vitit 2024, por të cilat nuk janë realizuar. Në lagjen rome në Prelluzhë, kemi qenë të rrezikuar nga antena, e cila gjendet aty. Kam kërkuar vendosjen e pengesave (policëve të

shtrirë) në rrugë, edhe kjo nuk është realizuar. Po ashtu, kam kërkuar që të përfundohet kanalizimi për tri shtëpi që ka mbetur në gjysmë, por edhe kjo nuk është realizuar. Shpresoj se në vitin 2025 do të realizohen këto kërkesa që i kam parashtruar.

**Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit** – theksoi se këto probleme dhe të gjitha problemet tjera që i kemi diskutuar janë të paraqitura në raportin vjetor.

*Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi Raportin vjetor për vitin 2024.*

3. Diskutime lidhur me hartimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025.

**Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit** – ju kisha lutur të gjithëve që të kontribuoni në këtë temë që bashkërisht ta bëjmë planin e punës.

**Berat Maloku, anëtar i komitetit** – tha se është viti i fundit i mandatit tonë dhe nuk isha dal shumë jashtë binarëve të planit të vitit 2024. Besoj që ky vit do na shkojë mirë, sepse jemi mësuar nga tri vitet e kaluara. Dua t'i falënderoj të gjithë anëtarët e komitetit, sepse sipas meje kemi punuar mjaft për këto tri vite. Por, besoj që mund të punojmë edhe më shumë në të mirë të të gjitha komuniteteve. Duhet të kërkojmë nga kryetari i komunës që të bëjë presion tek drejtorët e drejtorive në mënyrë që të marrin pjesë në mbledhjet e komitetit kur t'i ftojme.

Është mirë që të bëjmë vizita më të shpeshta në terren që t'i vizitojmë komunitetet. Lidhur me këtë, KFOR-i është shumë aktiv sa u përket vizitave në terren dhe mund ta bëjmë një grup prej 2-3 personave dhe bashkërisht mund të dalim në terren. Kurse, nga UNMIK-u dhe OSBE-ja kërkoj që të na ndihmojnë në hartimin e projekteve, që si komitet të hartojmë projekte për realizimin e aktiviteteve tona.

**Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit** – lidhur me planin e punës, edhe unë e kam të njëjtin mendim me Beratin që mos me u largu shumë nga plani i vitit të kaluar. Edhe pse ndoshta nuk kemi mundur aq shumë të bëjmë, e rëndësishme është që kemi pasur një diskutim të shëndoshë për t'i shqyrtuar së bashku problemet. Draft-planin do ta hartojë dhe do t'ua përcjelli që ta analizoni dhe në mbledhjen tjetër ta miratojmë.

4. Të ndryshme.

**Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit** – dua të ju falënderoj të gjithëve për këto tri vite dhe të bëjmë përpjekje të punojmë edhe më shumë në këtë vit që na ka mbetur në të mirë të komuniteteve tona.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:10.**

**Bujar Klinaku**

*Bujar Klinaku*  
**Procesmbajtës**

